



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË

I.Numër:05-400/01-25061, dt. 29 Maj 2025

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12 al. 2. pika d) të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28. datë: 04. Qershor 2008"), nenit 3 paragrafi 3.6. të Rregullores Nr. 02/2016 për tituj të nderit, dekorata, medalje, mirënjohje dhe falënderime dt. 01. Prill 2016, dhe nenit 13 paragrafi 1. pika 1.20. të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I.Numër:01-016/01-413431 të dt: 30. Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 29 Maj 2025, në propozim të komisionit të kuvendit dhe rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, merr:

VENDIM

Nr. 54/2025

Për dhënien e titullit "Mirënjohje"

Z. Vehbi (Tahir) Shala

1. **Z. Vehbi (Tahir) Shala**, nga Fsh. Loxhë, Komuna e Pejës, i jepet **"Mirënjohje"**, me motivacion:

"Për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në promovimin e arsimit, si mësues i gjuhës dhe letërsisë shqipe për më shumë se 40 vjet në shkollën "Ali Hadri" në Pejë, ai u bë jo vetëm bartës i dijes, por edhe mbrojtës i identitetit kombëtar në kohërat e errëta për Kosovën. Gjatë pushtimit, ai ishte pjesë e organizimit të shkollës paralele, ku drejtoi me përkushtim Pikën Kapeshnica, një nga qendrat arsimore të kohës. Pasluftës së fundit, në rolin e drejtorit të Shkollës së Mesme "Ali Hadri", tregoi vizion të lartë menaxherial dhe strategjik".

2. Ky fakt do të evidentohet në regjistrin e veçantë të Qytetarëve të dekoruar nga Komuna e Pejës, të cilin e mban Kuvendi Komunal dhe kryetari i Komunës.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Pejës.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në Ueb faqen zyrtare të Komunës së Pejës.



KRYESUESI I KUVENDIT,

Z. Rexhep Kurtbogaj